



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Glllogocit

Opština Glllogoc – Municipality of Glllogoc

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit



PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2020

Janar, 2020

PËRMBAJTJA E PËRGJITHSHME

- I. HYRJE
- II. SEKTORI I PLANIFIKIMIT URBAN
- III. SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT
- IV. PROCESI I LEGALIZIMIT

I. HYRJE

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT, NË ASPEKTIN FUNKSIONAL ËSHTË E ORGANIZUAR NË DY SEKTORË:

1. SETORI I PLANIFIKIMIT URBAN
2. SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Drejtoria në përgjithësi dhe sektoret e saj në veçanti janë të obliguara të ndërmarrin hapat dhe veprimet procedurale, konform përgjegjësiave për realizimin e objektivave të parapara me planprogramin e saj, me qëllim të inkorporimit të strategjisë dhe objektivave të ekzekutivit, gjithnjë duke u bazuar në obligimet që dalin nga:

- Ligjet dhe Rregulloret Komunale në fuqi
- Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Statuti 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008 i Komunës së Gllogocit

PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2020

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

DEKLARATA E MISIONIT:

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT ËSHTË BARTËSE E HARTIMIT TË: PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL, HARTAVE ZONALE DHE PLANEVE RREGULLATIVE URBANE TË HOLLËSISHME, BËNË IMPLEMENTIMIN E TYRE DHE LËSHON LEJET E NDËRTIMIT, KUJDESET PËR DOKUMENTACIONIN INVESTIVO-TEKNIK DHE PËRPUTHSHMËRINË E TIJ ME KUSHTET E DHËNA URBANO-TEKNIKE, LEJON SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE, MBULON SFERËN E BANIMIT, BASHKËPUNIMIN I NGUSHTË ME QEVERINË - MINISTRINË E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR (MMPH).

II. SEKTORI PËR PLANIFIKIM URBAN

Planifikimi dhe objektivat e përgjithshme të Sektorit për Planifikim Urban:

- 1.1 Përfundimi i Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, 2020-2028 sipas Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.
- 1.2 Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit, 2020-2028.
- 1.3 Dhënia në shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike,
- 1.4 Përgatitja dhe propozimi i lokacioneve për objekte të karakterit të përgjithshëm,
- 1.5 Shqyrtimi i kërkesave dhe lëshimi i kushteve, lejeve të ndërtimit në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim.
- 1.6 Lëshimi i Certifikatës së Përdorimit të objekteve.
- 1.7 Dhënia e pëlqimeve urbanistike për bashkim dhe parcelizim të parcelave kadastrale sipas Ligjit Nr.04/L-013 për Kadastër.
- 1.8 Hartimi i planeve rregulluese të hollësishme urbane.
- 1.9 Emërtimi i rrugëve dhe numrave në hyrje të objekteve.

III. SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Planifikimi dhe objektivat e përgjithshme të Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit:

- 1.1 Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal, 2020-2028.
- 1.2 Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, 2020-2028.
- 1.3 Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, 2020-2028.
- 1.4 Përgatitja e raporteve për gjendjen e zonave të mbrojtura në Komunën e Glllogocit.
- 1.5 Inicimi i procedurave për shpallje zonë e mbrojtur sipas Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.
- 1.6 Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të tokës, ujit, mjedisit dhe përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit.
- 1.7 Gjelbërimi i hapësirave publike.
- 1.8 Rregullimi i këndit të lodrave për fëmijë.

IV. PROCESI I LEGALIZIMIT

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe miratimin e pesë Udhëzimeve Administrative që dalin nga Ligji Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje trajtohen të gjitha ndërtimet pa leje deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit (5 shtator 2018), dhe janë krijuar parakushtet e nevojshme për fillimin e procesit të legalizimit dhe me këtë rast krijohet mundësia e pranimit të aplikacioneve për ndërtimet pa leje.

Për të filluar procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje duhet të bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm për aplikim siç është:

Shtojca 1- Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450m²).

Shtojca 1 A.- Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë I (përveç depove deri 1500 m²) dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450 m²).

Shtojca 1B. – Deklaratë e pronarit të ndërtimit pa leje.

Shtojca 2. – Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë II (jo shtëpitë).

Shtojca 2A. – Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit kategorinë II (jo shtëpitë).

Shtojca 3. – Formulari standard i aplikimit për lirim nga taksat për legalizimin e ndërtimit pa leje.

Drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
Flutura Avdiu

